



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA



**Strategjia për Sigurimin e Cilësisë në  
Fakultetin e Gjuhëve të Huaja  
2022 - 2024**

Miratuar me Vendimin e Dekanatit

Nr. 17 datë 27.03.2023



Fakulteti i Gjuhëve të Huaja harton Strategjinë për sigurimin e cilësisë bazuar në ligjin nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, në aktet nënligjore të dala në zbatim të tij; Kodin e Cilësisë të Arsimit të Lartë miratuar me vendim të KM- së; Statutin e Universitetit të Tiranës, Rregulloren "Për Sigurimin e Cilësisë në UT", Rregulloren për funksionimin e Njësive të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, Manualin e Cilësisë, si dhe Paketën e Instrumenteve të Cilësisë, miratuar nga Senati Akademik i Universitetit të Tiranës, me Vendimin nr. 51, datë 23.12.2020.

## Strukturat përbërëse dhe implementuese të Strategjisë së cilësisë

**1. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC)** në njësinë kryesore, është ngritur nga Fakulteti i Gjuhëve të Huaja me urdhër nr. 77, datë 02.07.2021. NJSBC është një strukturë ndihmësakadematike me karakter administrativ që ka autonomi operative dhe akses në të gjitha të dhënat e njësive kryesore. Kjo njësi ka si mision të planifikojë, drejtojë, organizojë dhe të publikojë veprimtarinë e kryer në kuadrin e sigurimit të cilësisë në nivelin e njësive kryesore. NJSBC-ja luan një rol të rëndësishëm në krijimin e kulturës së cilësisë që ndikon të arrijë dhe ruajë një cilësi të lartë të veprimtarisë akademike, kërkimore dhe shërbyese të FGJH-së.

**2. Njësitë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë** në njësitë bazë janë ngritur bazuar në “Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e Njësive të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, në UT”, me vendim nr. 14, datë 20.07.2022. NJSBC në njësinë bazë bashkëpunon me NJSBC-në e njësive kryesore për vlerësimin e brendshëm të njësive kryesore, dhe akreditimin institucional dhe të programeve. Në bashkëpunim me NJSBC-në e njësive kryesore dhe zyrën e cilësisë dhe kurikulave organizon vlerësimin studentor për cilësinë e mësimdhënies, në njësinë bazë, në fund të çdo semestri apo para sezonit të provimeve, si dhe përgatit raportin vjetor për sigurimin e cilësisë në nivelin e njësive bazë.



## Hyrje

Strategjia e sigurimit të cilësisë është një dokument kryesor ku përcaktohen prioritetet parësore të arsimit të lartë në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja. Misioni i tij është zhvillimi dhe rritja e cilësisë sipas standarteve të arsimit të lartë, ofrimit të programeve mësimore dhe aftësive të arritura në fushat akademike dhe shkencore të cilat janë në përputhje me tregun e punës. Rritja e cilësisë së shërbimit dhe, në veçanti, përsosja e nivelit të mësimdhënies arrihen nëpërmjet komunikimeve të vazhdueshme dhe të frytshme me studentët, të cilët janë pjesë përbërëse në organet qeverisëse. Fakulteti ynë ka në fokus gjithashtu zgjerimin dhe modernizimin e mjediseve, duke nisur që nga laboratorët, bibliotekat dhe informatizimi. Qëllimi kryesor i kësaj strategjie është arritja e cilësisë më të lartë në ofrimin e arsimit të lartë dhe integrimin e tij sipas standarteve të arsimit të lartë europian.

Prioritetet e strategjisë së sigurimit të cilësisë :

- Përmirësimi i cilësisë së programeve mësimore, bazuar në tregun e punës dhe kërkesat e studentëve.
- Përmirësimi i procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies, si dhe kushtet e punës.
- Përmirësimi i kërkimit shkencor dhe stimulimi e promovimi i punës pedagogjike të personelit akademik.

## Parimet për menaxhimin e cilësisë

1. **Studenti në fokus.** Ky parim nënkupton përmbushjen me cilësi të nevojave të studentëve dhe të infrastrukturës së nevojshme për të studiuar, përgatitjen e tyre cilësore në fushën e studimeve që ndjekin; garantimin e programeve të studimit në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe të shoqërisë shqiptare, garantimin e vlefshmërisë së diplomës që ata zotërojnë.
2. **Lidershipi.** Ky parim nënkupton se orientimi i veprimtarisë së FGJH-së sipas një vizioni, misioni dhe objektivave të zhvillimit ndihmon procesin e sigurimit të cilësisë dhe kërkon që sistemi i menaxhimit të cilësisë të ndërtohet në përputhje me to.
3. **Përfshirja e njerëzve.** Të gjithë anëtarët e komunitetit të FGJH-së kërkohet që të përfshihen në sigurimin e cilësisë duke i respektuar ata, pasi në këtë mënyrë secili jep kontribut për përmbushjen e objektivave të cilësisë, por shpreh edhe përgjegjshmëri.
4. **Qasja e procesit.** Ndërlidhja e të gjitha veprimtarive të FGJH-së dhe funksionimi si një sistem brenda institucionit ndihmon në optimizimin e sistemit dhe arritjen e rezultateve të qëndrueshme dhe të përcaktuara.
5. **Përmirësimi.** Suksesi është i lidhur me përmirësimin, veçanërisht në epokën e sotme të ndryshimit të shpejtë. Përmirësimi është i rëndësishëm për Universitetin për të ruajtur nivelin e arritur të performancës, për të reaguar ndaj ndryshimeve dhe për të krijuar mundësi të reja zhvillimi dhe niveli më të lartë cilësie.
6. **Vendimmarrja e bazuar në evidencë.** Sipas këtij parimi, faktet, evidenca dhe analiza e të dhënave çojnë drejt një objektiviteti në marrjen e vendimeve, drejt vendimeve më të mira që prodhojnë rezultate të dëshiruara.



7. **Menaxhimi i marrëdhënieve.** Sipas këtij parimi, palët e interesuara ndikojnë performancën e institucionit. Suksesi i qëndrueshëm arrihet kur institucioni menaxhon marrëdhëniet me palët e interesuara për të optimizuar ndikimin e tyre në performancën e tij.

### **Fushat e veprimtarive në kuadër të sigurimit të cilësisë**

Sigurimi i brendshëm i cilësisë përqendrohet në fushat e caktuara në Rregulloren e Cilësisë së UT-së, Statutin dhe në Kodin e cilësisë së arsimit të lartë. Fushat e vlerësimit të brendshëm janë: veprimtaria tërësore e institucionit, programet e studimit dhe mësimdhënia, kërkimi shkencor, arritjet e studentëve, shërbimet për studentët dhe performanca e personelit.

### **Objektivat**

#### **Objektivi 1. Zhvillimi i sigurisë së cilësisë dhe zbatimi i akteve rregullatore**

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja ka tashmë një sistem sigurimi të cilësisë relativisht të ri, i cili është angazhuar plotësisht në krijimin e të gjitha akteve rregullatore, si Rregullore, Strategji, plan veprimi, si dhe për zhvillimin e saj në të gjitha fushat përgjatë vitit të fundit. Ky fakt u ofron të gjithë aktorëve mundësinë për të përmirësuar vazhdimisht aktivitetet e tyre në të gjitha fushat e kërkimit dhe transferimit të njohurive.

#### **Veprimet që do të kryhen:**

- 1.1. Promovimi dhe informimi mbi kulturën e sigurimit të cilësisë.
- 1.2. Propozimi i një plani veprimi për të sjellë përmirësim, ndryshim, zhvillim.
- 1.3. Monitorimi dhe vlerësimi i përmbushjes së standarteve të programeve studimore.

#### **Rezultate të pritshme:**

- 1.1. Takimi informues me studentët dhe pedagogët.
- 1.2. Përditësimi i planit të veprimeve.
- 1.3. Përmirësimi i rregullores së sigurimit të cilësisë.
- 1.4. Kontrolli dhe rishikimi i programeve mësimore.
- 1.5. Kordinimi i punës për vetëvlerësimin e brendshëm dhe akreditimin e jashtëm.

#### **Objektivi 2. Gjithëpërfshirja dhe ndërgjegjësimi të të gjithë aktorët**

Përfshirja aktive e të gjitha palëve të interesuara në këtë cikël të vazhdueshëm monitorimi është thelbësor për Fakultetin. Ky proces sigurohet duke përfshirë drejtuesit e fakultetit, pedagogët, administratën, studentët dhe këshilltarët e jashtëm. Fakulteti kontribuon në pranimin e gjerë të procedurave të sigurimit të saj dhe në zhvillimin e një kulture të cilësisë.

#### **Veprimet që do të kryhen:**

- 2.1. Përfshirja dhe informimi i pedagogëve dhe studentëve në procesin e sigurimit të cilësisë.
- 2.2. Trajnimi i përfaqësuesve të NJSBC mbi procesin e monitorimit, vlerësimit, analizës dhe hartimit të raporteve.



2.3. Trajnime për GVB-të sipas nevojave gjatë procesit të vlerësimit të brendshëm.

**Rezultate të pritshme:**

2.1. Ndërgjegjësimi i pedagogëve dhe studentëve mbi procesin e sigurimit të cilësisë.

2.2. Monitorimi i shpërndarjes së pyetësorëve.

2.3. Koordinimi i procesit të vlerësimit të brendshëm.

**Objektivi 3. Identifikimi i nevojave**

Proceset e sigurimit të cilësisë zhvillohen sipas një "cikli të dyfishtë": së pari kryhet monitorimi dhe vlerësimi i një aktiviteti i cili bën të mundur identifikimin e pikave të forta dhe të dobëta të tij. Më pas për t'i korigjuar këto dhe për t'iu përgjigjur kërkesave, jepen rekomandimet dhe vendosen masat. Efektiviteti i tyre shqyrtohet pas një kohe aplikimi.

**Veprimet që do të kryhen:**

3.1. Organizimi i vlerësimit studentor për cilësinë e mësimdhënies.

3.2. Plotesimi i Formularit "Përmbledhëse e veprimtarisë së pedagogut".

3.3. Vlerësim i studentëve që diplomohen.

**Rezultate të pritshme:**

3.1. Nxjerrja e rezultateve nga pyetësorët e vlerësimit të lëndës dhe pedagogut.

3.2. Identifikimi i pikave të forta dhe të dobëta të veprimtarisë së përgjithshme të institucionit.

**Objektivi 4. Analizimi i rezultateve të matshëm dhe përcaktimi i rekomandimeve**

Zhvillimi i vazhdueshëm i sistemit të sigurimit të cilësisë, si përmirësimi i të gjitha aktiviteteve universitare, bazohet në analizën e rezultateve të vlerësimeve të brendshme dhe të jashtme dhe kryhet me masa përmirësimi, efektiviteti i të cilave më pas monitorohet dhe zhvillohet në përputhje me rrethanat.

**Veprimet që do të kryhen:**

4.1. Përcjellja e rezultateve të monitorimit dhe vlerësimit.

4.2. Analizimi i rezultateve dhe problematikave të nxjerra nga pyetësorët.

**Rezultate të pritshme:**

4.1. Hartimi i raporteve nga NJSBC-të në njësitë bazë.

4.2. Hartimi i raportit vjetor për njësinë kryesore nga NJSBC në FGJH.

4.3. Komunikimi dhe publikimi i rezultateve të vlerësimit në përputhje me Politikën e sigurimit të cilësisë së UT-së dhe të FGJH-së.

